



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 282 Prot.

1. 6. 2017

VENDIM

Nr. 13, datë 1 qershor 2017

Për shpalljen e organizimit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2017

Drejtuar : Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (më tej: ASHSH);
seksioneve shkencore, anëtarëve të Asamblesë së ASHSH-së.

Për dijeni: Sektorit të financës, sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve,
sektorit të botimeve shkencore dhe Bibliotekës Shkencore, specialistit
të marrëdhënieve me jashtë dhe komunikimeve shkencore, specialistit
të IT-së.

Në mbështetje të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika dh dhe neni 13; si dhe të rregullores Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre, neni 3, neni 4, pika 2, si dhe nenet 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12:

URDHËROJ:

1. Shpalljen e organizimit dhe thirrjen për pjesëmarrje në edicionin e dytë të *çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave për vitin 2017*, si më poshtë:
 - 1.1 Çmimi **Çabej**, çmim shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave shoqërore e albanologjike;
 - 1.2 Çmimi **Radovicka**, çmim shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave natyrore e teknike;
 - 1.3 Çmimi i **karrierës akademike**, çmim shkencor kombëtar vjetor;
 - 1.4 Çmimi për **kërkuesin e ri më të suksesshëm**, çmim shkencor kombëtar vjetor: 1 (një) çmim në fushën e shkencave shoqërore albanologjike dhe 1 (një) çmim në fushën e shkencave natyrore e teknike.
2. Shpallja e interesit për pjesëmarrje, sipas *Thirrjes për pjesëmarrje* bashkëlidhur këtij vendimi, fillon nga data 1 qershor 2017 dhe përfundon në datën 31 dhjetor 2017.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të ASHSH-së dhe në tri medie të shkruara kombëtare.
5. Ngarkohet sekretaria e Kryesisë së ASHSH-së për shpërndarjen e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretari Shkencor i ASHSH për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

KRYETARI

MUZAFER KORKUTI

